Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	sasia / Njesia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	Afati
1.	F.V SD-WAN NEXT GENERATION FIREWALL MAIN HUB	2/copë			Sipas termave specifikave
2.	F.V SD-WAN NEXT GENERATION FIREWALL SPOKE TIP.2	60/copë			Sipas termave specifikave
3.	F.V PLATFORMA E MENAXHIMIT	1/set			Sipas termave specifikave
4.	F.V SWITCH ME 24 PORTA	60/copë			Sipas termave specifikave
5.	F.V UPGRADE ME LICENCA TE SISTEMIT EKZISTUES CISCO UMBRELLA SECURE INTERNET GATEWAY	500/copë			Sipas termave specifikave
6.	F.V UPGRADE ME LICENCA TE SISTEMIT EKZISTUES PËR MENAXHIMIN E PAJISJEVE	1/set			Sipas termave specifikave

	DHE MONITORIMIN NE KOHE REALE				
7.	LAPTOP TË AVANCUAR	4 copë			Sipas termave specifikave
8.	MONITORË ADVACED 27"	14 copë			Sipas termave specifikave
9.	PAJISJE PËR NEVOJAT E HELPDESK	1/set			Sipas termave specifikave
10.	NDËRTIM RRJETI KOMPJUTERIK NË 60 DEGË	1/set			Sipas termave specifikave
11.	SHERBIME INSTALIMI DHE IMPLEMENTIMI ON-SITE	1/set			Sipas termave specifikave
12.	SHERBIME MIRMBAJTJE /SUPORTI REMOTE DHE ONSITE	1/Vit			Sipas termave specifikave
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike më tej referuar si OSHEE GROUP sh.a, është një institucion veprimtaria e të cilit kërkon që për nevoja të punës të prodhojë, ruajë, përpunojë, shpërndajë ose transmetojë informacion nëpërmjet rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit në përdorim ose në pronësi të saj. Ky informacion duhet të transferohet në mënyrë të sigurt dhe i pakompromentuar në kohë reale, për të lehtësuar veprimtaritë ditore dhe manuale në pikat periferike.

Për arsyet e lartpërmendura OSHEE GROUP sh.a kërkon të implementojë një teknologji të sigurt komunikimi të pikave periferike me Datacenter dhe ka zgjedhur teknologjinë SD-WAN.

Integrimi i SD-WAN me rrjetin ekzistues dhe pajisjet e sigurisë firewall të gjeneratës së ardhshme (NGFW) ofron një kombinim të pakrahasueshëm të aftësive dhe veçorive të avancuara të siguresë së rrjetit. Kjo sinergji është veçanërisht e vlefshme në ndërmarrjet moderne që kërkojnë rrjet të shkallëzueshëm, të sigurt dhe efikas për të mbështetur aplikacionet cloud, punën në distancë dhe degët e shpërndara në vendndodhje të ndryshme.

Funksionalitetet e SD-WAN duhet të lejojnë konfigurim të automatizuar iBGP, shpërndarjen në mënyrë automatike të rrugëzimeve, mbështetjen e komunitetit TAG për etiketimin e itinerareve, drejtimin inteligjent të trafikut nëpërmjet monitorimit të pathe-ve, akses të drejtpërdrejtë në internet dhe monitorimin e pathe-ve WAN PBR për drejtimin e trafikut të bazuar në aplikacion përmes lidhjeve direkte në internet ose tunele VTI, duke përdorur metrika në kohë reale për të siguruar rrugën më të mirë të daljes.

Gjithashtu duhet të mundësojë drejtimin e trafikut bazuar në metrikat e ndërfaqes të monitoruara në mënyrë dinamike, si Koha e Udhëtimit vajtje-ardhje (RTT), Jitter, Humbja e Paketave dhe Rezultati Mesatar i Opinioneve (MOS).

Infrastruktura duhet të lidhë 60 degë periferike me qendrën e të dhënave të prodhimit dhe disastër recovery, si dhe shërbimet e institucionit duke përdorur lidhjet ekzistuese dhe duke optimizuar përdorimin e trafikut.

Zgjidhja e propozuar duhet të integrohet me zgjidhjen ekzistuese Cisco Umbrella, në mënyrë që të arrijmë mbulim gjithëpërfshirës të sigurisë duke mundësuar qasje të drejtpërdrejtë në internet në zyrat e degëve, me siguri të fortë pa kompromentuar shpejtësinë ose besueshmërinë.

OSHEE GROUP sh.a do të përfitojë nga implementimi i kësaj zgjidhjeje një sere veçorish të paraqitura si më poshtë:

1. Siguri e përmirësuar me veçori të integruara me firewall të gjeneratës së afërme (NGFW):
 - SD-WAN përdor NGFW-të për të siguruar inspektim të thellë të paketave, parandalimin e ndërhyrjeve dhe mbrojtje të avancuar nga kërcënimet. Këto veçori mbrojnë rrjetin kundër kërcënimeve kibernetike në zhvillim.
 - Mbrojtje të unifikuar nga kërcënimet duke siguruar portat web me qasje në internet, mbrojtjen e malware dhe filtrimin e URL-së direkt në strukturën SD-WAN, duke siguruar që i gjithë trafiku të jetë i sigurt.
2. Optimizim të performancës të Aplikacioneve:
 - SD-WAN i jep përparësi aplikacioneve kritike duke i drejtuar në mënyrë dinamike trafikun nëpër itinerareve më të mira të disponueshme, duke reduktuar vonesën dhe duke përmirësuar përvojën e përdoruesit.

-
- Karakteristikat e NGFW mundësojnë ndërgjegjësimin në nivel aplikacioni, duke lejuar kontroll të imtësishtëm të përdorimit të gjerësisë së brezit dhe duke siguruar që aplikacionet kritike të performojnë në mënyrë optimale.

3. Menaxhim të qendërzuara :

- Ekipet e IT-se mund të menaxhojnë SD-WAN dhe politikat e sigurisë në të gjitha degët dhe qendrat e të dhënave nga një panel i vetëm.
- Kjo thjeshton zbatimin e politikave, redukton gabimet në konfigurime dhe siguron standarde të qëndrueshme sigurie në të gjithë rrjetin.

4. Lidhje më të thjeshtuar dhe të sigurtë me degët/branch :

- Zgjidhja mundëson provizionim zero-touch, duke e bërë më të lehtë lidhjen e degëve të reja dhe integrimin e tyre të sigurt në rrjetin qendror.
- NGFW-të sigurojnë komunikim të sigurt midis zyrave të degëve dhe aplikacioneve në cloud, duke mbrojtur të dhënat në transportim.

5. Mbështetje të zgjidhjeve Cloud-Native :

- SD-WAN është krijuar për të punuar pa probleme me mjediset multi-cloud, duke rritur performancën për aplikacionet SaaS si Microsoft 365, Salesforce dhe Google Workspace.
- NGFW-të zbatojnë politika të qëndrueshme sigurie në trafikun cloud, duke siguruar të dhëna të ndjeshme dhe duke ruajtur pajtueshmërinë e tyre.


6. Vizibilitet dhe analizë të përmirësuar :

- Monitorimi në kohë reale dhe analiza të detajuara ofrojnë njohuri mbi modalitete të trafikut, performancën e aplikacionit dhe kërcënimet e mundshme të sigurisë.
- Threat Response integrohet me NGFW për të ofruar inteligjencë vepruese, duke ndihmuar ekipet e IT të adresojnë çështjet e ndryshme në mënyrë proaktive.

7. Qëndrueshmëria dhe shkallëzueshmëria :

- SD-WAN mbështet balancimin e ngarkesës dhe dështimin, duke siguruar disponueshmëri të lartë dhe qëndrueshmëri ndaj ndërprerjeve të rrjetit.
- Karakteristikat e NGFW shkallëzohen me rrjetin, duke mbështetur zhvillimin e institucionit duke adaptuar teknologji të reja.

OSHEE GROUP sh.p.k kërkon një zgjidhje e cila duhet të integrohet plotësisht me zgjidhjen ekzistuese Cisco Umbrella, në mënyrë që të mund të arrijmë mbulim gjithëpërfshirës të sigurisë duke mundësuar akses të drejtpërdrejtë në internet në zyrat e degëve/branch, pa kompromentuar shpejtësinë apo besueshmërinë.



1. F.V SD-WAN NEXT GENERATION FIREWALL MAIN HUB.

Më poshtë kërkesat minimale për elementët e funksionaliteteve SD-WAN dhe NGFW:

- Pajisje modulare 1RU, me të paktën 8 x RJ45 dhe 8 x 1/10G SFP/SFP+.
- Mundësi për të shtuar 8 porte 1G/10G SFP+.
- Të mbështesë kapacitetin e firewall-it me kontroll të aplikacionit minimalisht 15 Gbps.
- Të ketë kapacitet të firewall-it me kontroll aplikacioni dhe NGIPS minimalisht 15 Gbps.
- Të paktën 1 Gigabit port të integruar Ethernet për menaxhim.
- Të ketë mbështetje për të paktën 130.000 sesione të reja/sek.
- Të ketë mbështetje për të paktën 2.000.000 sesione të njëkohshme.
- Të ketë mbështetje për të paktën 1000 ndërfaqe VLAN
- Të ofroje furnizime me rrymë AC 220 V hotswap redundante dhe 900 GB hapësirë ruajtëse
- Mbështetje për LACP dhe integrim me Active Directory / LDAP
- Sistemi duhet të jetë në gjendje të punojë në modalitetin Routed(L3) dhe Switched (L2) në të njëjtën kohë, si dhe të jetë në gjendje të ndajë dhe përdorë disa ndërfaqe (apo çifte ndërfaqesh) në modalitetin NGIPS (në linjë ose pasive)
- Sistemi duhet të jetë në gjendje të shohë përtej paketës dhe të ofrojë analizë dhe mbrojtje kontekstuale të kërcënimeve duke patur dukshmëri të pikës fundore me aplikacionet, OS, dobësitë, informacionin e pajisjes, përdoruesit e lidhur me ngjarjet e sigurisë.

- Sistemi duhet të ofrojë shërbime të reputacionit IP dhe analiza të të dhënave për të mohuar automatikisht adresat IP me reputacion të ulët, CnC dhe lidhje të tjera të ngjashme.
- Sistemi duhet të ketë indikacione kompromisi (IOC) të bazuara në host dhe nga përdoruesi.
- Sistemi duhet të ketë disponueshmëri të lartë aktive/active dhe aktive/standby.
- Mbështetje për politikat e bazuara në DNS, me aftësinë për të ridrejtuar pyetjen DNS në një server sinkhole.
- IPS dhe sistemi i kontrollit të aplikacionit duhet të kenë rregulla zbulimi të bazuara në një gjuhë të zgjeruar dhe të hapur që u mundëson përdoruesve të krijojnë rregullat e tyre.
- Rregullat e zbulimit të ofruara nga shitësi duhet të dokumentohen, me përshkrime të plota të identitetit, natyrës, ashpërsisë së dobësive dhe kërcënimeve të lidhura që mbrohen kundër.
- Sistemi nëpërmjet një motor zbulimi duhet të përfshijë qasje të shumta për zbulimin e kërcënimeve, duke përfshirë minimalisht nënshkrimet e bazuara në shfrytëzim, rregullat e bazuara në cenueshmëri, zbulimin e anomalive të protokollit dhe teknikat e zbulimit të anomalive të sjelljes.
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të ofrojë automatikisht inspektimet dhe mbrojtjen e duhur për aplikacionet dhe trafikun e dërguar përmes portave jo standarde të komunikimit - sistemi i kontrollit të aplikacioneve duhet të mbështesë të paktën 4000 aplikacione.
- Sistemi duhet t'i ofrojë përdoruesit mundësinë për të shkruar detektorë të personalizuar të aplikacioneve në gjuhën me burim të hapur.
- Motori i zbulimit të ndërhyrjeve duhet të jetë në gjendje të inspektojë trafikun e lidhur me segmente të ndryshme të rrjetit në mënyra të ndryshme (në krahasim me të paturit vetëm një politikë për ndërfaqe).
- Motori i zbulimit të ndërhyrjeve duhet të mbështesë opsione të shumta për t'iu përgjigjur drejtpërdrejt ngjarjeve, të tilla si: vetëm monitorimi, bllokimi i trafikut fyes, zëvendësimi i ngarkesës së paketave dhe kapja e tyre.
- Zgjidhja duhet të ketë sigurinë e inteligjencës së kërcënimit IP, URL dhe DNS.
- Sistemi duhet të mbështesë funksion për analizë të skedarëve dhe të përdorë analitikë të të dhënave të mëdha në cloud për të vazhduar inspektimin e të dhënave/skedarëve të klasifikuar dhe të paklasifikuar pas vendosjes fillestare të një objekti me mbështetje për analiza të vazhdueshme me retrospektivë, identifikimin e shkakut rrënjësor, përcaktimin e shtrirjes në kohë reale dhe inteligjencën globale të sigurisë për të gjurmuar, analizuar dhe korrigjuar malware të avancuar.
- Sistemi duhet të mbështesë zgjedhje dinamike bazuar në politika dhe path-e të aplikacioneve nëpër lidhje të shumta WAN.
- Sistemi duhet të mbështesë rrugëzimin e bazuar në politikë (PBR) duke përdorur aplikacionet si kritere të përpuethshme.
- Sistemi duhet të ketë support për “equal-cost multipath ECMP” për balancimin e ngarkesës në shumë ISP dhe VTI.
- Sistemi duhet të mbështesë konfigurim për ISP të dyfishtë.

- Sistemi te kete mbështetje për tunelet VPN të bazuara në rrugëzime (VTI) midis zyrave qendrore dhe degëve.
- Sistemi te kete mbështetje për zgjedhje te path-ve optimale dhe monitorimin e tyre te bazuara ne aplikacion.
- Sistemi te kete mbështetje për BGP IPv4/v6, OSPFIPv4/v6 dhe IPv4 EIGRP mbi VTI.
- Sistemi te kete mbështetje për tunele te HUB me nderfaqe dinamike virtuale që suportojne Spoke me IP statike ose dinamike.
- Sistemi te kete mbështetje për rrugëzimin e bazuar në politikë (PBR) duke përdorur monitorimin e path-ve http, identitetin e perdoruesit dhe SGT.
- Sistemi te kete mbështetje për qasje të drejtpërdrejtë në internet/rrugezim të bazuar në politika.
- Sistemi te kete mbështetje për rrugëzimin e bazuar në politikë (PBR) me llojet e mëposhtme metrike: jitter minimal, kohe minimale vajtje-ardhje, humbje minimale e paketave.
- Sistemi firewall i ofruar duhet te integrohet plotesisht me zgjidhjet aktuale te implementuar Cisco Umbrella Secure Internet Gateway e cila ben mbrojtjen e trafikut DNS duke e kategorizuar ne disa nivele: low, medium, high.
- Sistemi firewall i ofruar duhet te integrohet plotesisht me zgjidhjet aktuale te implementuar Cisco Identity Services Engine e cila ben autentikimin, autorizimin, aksesimin e pajisjeve fundore ne protokollet RADIUS/TACACS dhe perdoruesve (userave) me protokollin Dot1x.
- Sistemi firewall i ofruar duhet te integrohet plotësisht me pajisjet firewall te siguresë Cisco Firepower 2130 dhe platformën e menaxhimit ekzistuese Cisco Firepower Management Center, si dhe rutimet dinamike te implemetuara ne infrastrukturën aktuale.
- Suport nga prodhuesi me akses përmes postës elektronike, telefonit, faqes së internetit për një periudhë minimale prej 1 viti
- Përditësimet e softuerit të sistemit, përditësimet e nënshkrimeve për një periudhë minimale prej 1 viti
- Të gjitha licencat e nevojshme për shërbimet e përshkruara të sigurisë për një periudhë minimale prej 1 viti

2. F.V SD-WAN NEXT GENERATION FIREWALL SPOKE.

Më poshtë kërkesat minimale për elementët e funksionaliteteve SD-WAN dhe NGFW

- Të paktën 8x 1000BASE-T Gigabit Ethernet (përfshire 2 porta PoE+ IEEE 802.3at), dhe 200 GB hapësirë ruajtëse.
- Të paktën 1 Gigabit port të integruar Ethernet për menaxhim.
- Te mbeshtese kapacitet të firewall-it me kontroll aplikacioni dhe NGIPS minimalisht 800 mbps.
- Të mbështesë kapacitet 400 Mbps IPSec VPN dhe 75 VPN peer.
- Sistemi duhet të mbështesë 6.000 sesione të reja/sek dhe 100.000 sesione të njëkohshme.
- Sistemi duhet të jetë në gjendje të shohë përtej paketës dhe të ofrojë analizë dhe mbrojtje kontekstuale të kërcënimeve duke patur dukshmëri të pikës fundore me

aplikacionet, OS, dobësitë, informacionin e pajisjes, përdoruesit e lidhur me ngjarjet e sigurisë.

- Sistemi duhet të ofrojë shërbime të reputacionit IP dhe analiza të të dhënave për të mohuar automatikisht adresat IP me reputacion të ulët, CnC dhe lidhje të tjera të ngjashme.
- Sistemi duhet të ketë indikacione kompromisi (IOC) të bazuara në host dhe nga përdoruesi.
- Sistemi duhet të ketë disponueshmëri të lartë aktive/standby.
- Mbështetje për politikën e bazuara në DNS, me aftësinë për të ridrejtuar pyetjen DNS në një server sinkhole.
- IPS dhe sistemi i kontrollit të aplikacionit duhet të kenë rregulla zbulimi të bazuara në një gjuhë të zgjeruar dhe të hapur që u mundëson përdoruesve të krijojnë rregullat e tyre.
- Rregullat e zbulimit të ofruara nga shitësi duhet të dokumentohen, me përshkrime të plota të identitetit, natyrës, ashpërsisë së dobësive dhe kërcënimeve të lidhura që mbrohen kundër.
- Sistemi nepermjet nje motor zbulimi duhet të përfshijë qasje të shumta për zbulimin e kërcënimeve, duke përfshirë minimalisht nënshkrimet e bazuara në shfrytëzim, rregullat e bazuara në cenueshmëri, zbulimin e anomalive të protokollit dhe teknikat e zbulimit të anomalive të sjelljes.
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të ofrojë automatikisht inspektimet dhe mbrojtjen e duhur për aplikacionet dhe trafikun e dërguar përmes portave jo standarde të komunikimit - sistemi i kontrollit të aplikacioneve duhet të mbështesë të paktën 4000 aplikacione.
- Sistemi duhet t'i ofrojë përdoruesit mundësinë për të shkruar detektorë të personalizuar të aplikacioneve në gjuhën me burim të hapur.
- Motori i zbulimit të ndërhyrjeve duhet të jetë në gjendje të inspektojë trafikun e lidhur me segmente të ndryshme të rrjetit në mënyra të ndryshme (në krahasim me të paturit vetëm një politikë për ndërfaqe).
- Motori i zbulimit të ndërhyrjeve duhet të mbështesë opsione të shumta për t'iu përgjigjur drejtpërdrejt ngjarjeve, të tilla si: vetëm monitorimi, bllokimi i trafikut fyes, zëvendësimi i ngarkesës së paketave dhe kapja e tyre.
- Zgjidhja duhet të ketë sigurinë e inteligjencës së kërcënimit IP, URL dhe DNS.
- Sistemi duhet të mbështesë zgjedhje dinamike bazuar në politika dhe path-e të aplikacionve nëpër lidhje të shumta WAN.
- Sistemi duhet të mbështesë rrugëzimin e bazuar në politikë (PBR) duke përdorur aplikacionet si kritere të përpuethshme.
- Sistemi duhet të ketë support për “equal-cost multipath ECMP” për balancimin e ngarkesës në shumë ISP dhe VTI.
- Sistemi duhet të mbështesë konfigurim për ISP të dyfishtë.
- Sistemi të ketë mbështetje për tunelet VPN të bazuara në rrugëzime (VTI) midis zyrave qendrore dhe degëve.
- Sistemi të ketë mbështetje për zgjedhje të path-ve optimale dhe monitorimin e tyre të bazuara në aplikacion.
- Sistemi të ketë mbështetje për BGP IPv4/v6, OSPFIPv4/v6 dhe IPv4 EIGRP mbi VTI.

- Sistemi te kete mbështetje për tunele te HUB me nderfaqe dinamike virtuale që suportojne Spoke me IP statike ose dinamike.
- Sistemi te kete mbështetje për rrugëzimin e bazuar në politikë (PBR) duke përdorur monitorimin e path-ve http, identitetin e perdoruesit dhe SGT.
- Sistemi te kete mbështetje për qasje të drejtpërdrejtë në internet/rrugezim të bazuar në politika.
- Sistemi te kete mbështetje për rrugëzimin e bazuar në politikë (PBR) me llojet e mëposhtme metrike: jitter minimal, kohe minimale vajtje-ardhje, humbje minimale e paketave.
- Sistemi firewall i ofruar duhet te integrohet plotesisht me zgjidhjet aktuale te implementuar Cisco Umbrella Secure Internet Gateway e cila ben mbrojtjen e trafikut DNS duke e kategorizuar ne disa nivele: low, medium, high.
- Sistemi firewall i ofruar duhet te integrohet plotesisht me zgjidhjet aktuale te implementuar Cisco Identity Services Engine e cila ben autentikimin, autorizimin, aksesimin e pajisjeve fundore ne protokollet RADIUS/TACACS dhe perdoruesve (userave) me protokollin Dot1x.
- Sistemi firewall i ofruar duhet te integrohet plotësisht me pajisjet firewall te siguresë HUB, Cisco Firepower 2130 dhe platformën e menaxhimit ekzistuese Cisco Firepower Management Center, si dhe rutimet dinamike te implemetuara ne infrastrukturën aktuale
- Suport nga prodhuesi me akses përmes postës elektronike, telefonit, faqes së internetit për një periudhë minimale prej 1 viti
- Përditësimet e softuerit të sistemit, përditësimet e nënshkrimeve për një periudhë minimale prej 1 viti
- Të gjitha licencat e nevojshme për shërbimet e përshkruara të sigurisë për një periudhë minimale prej 1 viti

3. F.V PLATFORMA E MENAXHIMIT.

Sistemet e propozuara të Firewall-it duhet të përdorin platformën FMC (Cisco Firepower Management Center) ekzistuese te dedikuar të jashtëm e cila përdoret për menaxhimin e politikave, menaxhimin e ngjarjeve dhe informacionit me raportimin e ndërlidhur SIEM, menaxhimin e cenueshmërisë, mjekësinë ligjore të rrjetit dhe të dhënave dhe korrigjimin në të gjithë sistemin - brenda një ndërfaqe të vetme të bazuar në ueb:

- Zgjidhja duhet të ofrohet si upgrade me licenca për min 300 pajisjeve firewall për kontratën 203501802 .
- Sistemi duhet të ofrojë shikueshmëri totale të rrjetit të klientit, duke përfshirë hostet fizikë dhe virtualë, pajisjet celulare, sistemet operative, aplikacionet e pikave fundore gjenerike (si printerët, telefonat IP), përdoruesit, përmbajtjen dhe dobësitë e mundshme të hostit dhe malware.
- Sistemi duhet të jetë në gjendje të adoptojë automatikisht mbrojtje ndaj ndryshimeve dinamike në rrjet, në skedarë ose ne host, pa nevojën e ndërhyrjes së administratorit.
- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të mbledhë në mënyrë pasive informacione për hostet e rrjetit dhe aktivitetet e tyre, të tilla si sistemi operativ, shërbimet, portat e hapura, aplikacionet e klientit dhe dobësitë, për të ndihmuar me aktivitete të shumta, të tilla si

korrelacioni i të dhënave të ngjarjeve të ndërhyrjes, eliminimi i false/pozitiv, dhe përputhshmërinë e politikave

- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të mbledhë informacion në lidhje me flukset e sesioneve për të gjithë hostet e monitoruar, duke përfshirë kohën e fillimit/mbarimit, portet, shërbimet dhe sasinë e të dhënave.
- Zgjidhja duhet të sigurojë një hartë të rrjetit në kohë reale të të gjitha aseteve në rrjet. Ai duhet të përmbajë detaje të të gjithë informacionit të zbuluar që lidhet me informacionin se çfarë është një aset, përdoruesit e tij, shërbimet e ofruara dhe aplikacionet në përdorim.
- Sistemi duhet të ketë flamuj ndikimi për të sinjalizuar automatikisht ngjarjet më kritike
- Sistemi duhet të ketë indikacione të zbatueshme për kompromis për të lidhur informacionin e ngjarjeve të rrjetit
- Platforma e menaxhimit duhet të sigurojë një dashboard të personalizueshëm.
- Platforma e menaxhimit duhet të jetë e aftë për administrim bazuar në role, duke mundësuar grupe të ndryshme pamjesh dhe aftësi konfigurimi për administratorë të ndryshëm pas vërtetimit të tyre.
- Platforma e menaxhimit duhet të ofrojë mundësinë për të parë rregullin përkatës të zbulimit për çdo ngjarje të zbuluar, së bashku me paketat specifike që shkaktuan aktivizimin e tij.
- Platforma e menaxhimit duhet të jetë në gjendje të regjistrojë të gjitha aktivitetet e administratorit, si në nivel lokal ashtu edhe në një server në distance të largët.
- Komunikimet ndërmjet platformës së menaxhimit dhe firewall-it duhet të jenë të sigurta.

Firewall-et dhe sistemi i menaxhimit duhet të kenë:

- Suport nga prodhuesi me akses përmes postës elektronike, telefonit, faqes së internetit për një periudhë minimale prej 1 viti
- Përditësimet e softuerit të sistemit, përditësimet e nënshkrimeve për një periudhë minimale prej 1 viti
- Të gjitha licencat e nevojshme për shërbimet e përshkruara të sigurisë për një periudhë minimale prej 1 viti

4. F.V SWITCH ME 24 PORTA.

Karakteristika Minimale Teknike	
Ndërfaqet dhe karakteristikat hardware	
Porta 10/100/1000Mbps RJ45 (Auto Negocim /Auto MDI/MDIX)	≥ 24
Porta SFP	4 porta Gigabit Ethernet
Porta Combo	Opsionale

Porta Console	1
Instalimi në Rack	19'' Rack Mountable
HYRJE "INPUT"	
Tensioni Nominal	100~240 V AC
Frekuenca	50/60 Hz
PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI	
Switching Capacity	≥ 56 Gbps
Throughput	≥ 41 Mpps
Flash Memory	256 MB
RAM	512 MB
Jumbo Frame	Opsionale
Tabelë të Adresave MAC	16k
Fan	Opsionale
STANDARDET	
IEEE 802.3 - 10BASE-T	Po
IEEE 802.3u - 100BASE-T	Po
IEEE 802.3ab - 1000BASE-T	Po
IEEE802.3z - 1000BASE-X	Po
IEEE 802.3ad - Agregim linku	Po
IEEE 802.3x - full duplex on 10BASE-T, 100BASE-TX, and 1000BASE-T ports	Po
IEEE 802.1d - Spanning Tree Protocol	Po
IEEE 802.1s - multi STP	Po
IEEE 802.1w - RSTP	Po
IEEE 802.1q - VLAN	Po
IEEE 802.1x - Port-based Network Access	Po
IEEE 802.1p - QoS Classification	Po
IEEE 802.3af - PoE	Opsionale

IEEE 802.3at - PoE	Opsionale
SISTEMI OPERATIV	
Të jetë i orientuar për operacionet LAN	Po
Të ketë mundësi për upgrade	Po
QUALITY OF SERVICE	
Priority Queues	Po
Queue Scheduling	SP, WRR
VECORITË NË LAYER 2 DHE 3	
IGMP Snooping	V1/V2/V3
Spanning Tree	STP/RSTP/MSTP
LLDP	Po
BPDU Filtering/Guard	Po
Detektim të Loopback	Po
802.3x Flow Control	Po
VLAN	4k, (Voice VLAN Opsional)
Agregim të Linkeve	802.3ad LACP
Adresimi IPv6	Po
DHCP/BOOTP, DHCP Snooping, DHCP Option82 për klientët	Po
Dynamic ARP inspection (DAI)	Po
Limitim të Shpejtësisë	Port/Flow
Policy-Based Routing (PBR)	Jo
Routimi	Jo
SIGURIA	
Access Control List	L2 - L4
TCP/UDP Ports	Po
Protokollin DSCP	Po
Authentication	TACACS+, RADIUS, IEEE 802.1X, Port/MAC, SSH v1/v2, SSLv2/v3/TLSv1
Storm Control	Broadcast, Multicast, Unicast
MENAXHIMI	

Web-based GUI dhe CLI	Po
RS-232 Console / RJ-45 Console	Po
Telnet, SSH	Po
Monitorim të CPU	Po
SNTP	Po
Upgrade të Firmware	TFTP ose ndërfaqes Web
Ekran LED	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

5. F.V UPGRADE ME LICENCA TE SISTEMIT EKZISTUES CISCO UMBRELLA SECURE INTERNET GATEWAY.

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade me licenca sistemin aktual te sigurisë Cisco Umbrella Secure Internet Gateway.

- Upgrade të përfshijë 500 user-a dhe të jetë pjesë e kontratës aktuale **Sub1899006**.
- Keto licenca duhet te shtohen ne kontratën aktuale dhe do te shërbejnë per mbrojtjen e trafikut DNS ne branch-et/degët ku do te implementohet zgjidhja SD-WAN.
- Garancia duhet të ofrohet për një periudhë një vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit, email, chat apo telefon.
- Garancia e ofruar duhet të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi.

6. F.V UPGRADE ME LICENCA TE SISTEMIT EKZISTUES PËR MENAXHIMIN E PAJISJEVE DHE MONITORIMIN NE KOHE REALE.

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade me licenca sistemin aktual te sigurisë ManageEngine OpManager Professional Edition.

- Upgrade të përfshijë 250 user-a (pajisje) dhe të jetë pjesë e kontratës aktuale Customer ID:**202008-111-01225**.
- Garancia duhet të ofrohet për një periudhë një vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit, email, chat apo telefon.
- Garancia e ofruar duhet të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi.

7. SPECIFIKIME TEKNIKE TË LAPTOP

OSHEE sh.a. kërkon të blejë 4 LAPTOP të avancuar për nevojat e Departamentit të IT me karakteristikat e mëposhtme:

Aksesorë të përfshirë	140W USBC Power Adapter
Audio	6 altoparlantë
Jetëgjatësia e baterisë	20 orë
Versioni i Bluetooth	5.3
Ndriçimi	1000 nits
CD/DVD/Blu-ray Drive	JO
Kamera frontale	1080p HD camera
Kamera e pasme	JO
Pikët minimale të procesorit (cpubenchmark.net)	18 000 pikë
Memorie e brendshme	1TB SSD
Display	Liquid Retina XDR display, True Tone technology, 1 billion colours, Wide colour (P3), XDR brightness: 1,000 nits sustained full-screen
Karta grafike	e Integruar
Tastiera	Backlit, Chiclet Keys
RAM	48GB
Memory Card Slots	SDXC
Numri i core të procesorit	16
Office Pre-Installed	JO
Sistemi operativ	Windows 11 Pro/ MAC OS / Linux
Refresh Rate	120Hz
Refresh Rate Range	76-120Hz
Madhësia e ekranit	15.6"
Rezolucioni i ekranit	3456 x 2234 pixels

Sensors	Fingerprint Recognition, Microphone
Wired Connections	3x Thunderbolt 4, SDXC card slot, HDMI port, 3.5mm headphone jack
Wireless	WiFi 6 - 802.11ax

8. SPECIFIKIME TEKNIKE TË MONITOREVE

OSHEE sh.a. kërkon të blejë 14 Monitorë të avancuar për përdorime të veçanta me karakteristikat e mëposhtme:

Ekrani	Madhësia e ekranit (inch): ≥ 27 Pixels Per Inch (PPI) : ≥ 105 Aspect Ratio : 16:9 Hapësira e piksel : 0.233mm Rezolucioni i ekranit : $\geq 2560 \times 1440$ Hapësira e ngjyrave (sRGB) : 100% Hapësira e ngjyrave (DCI-P3) : 95% Bardhësia (HDR, Peak) : $\geq 400 \text{ cd/m}^2$ Bardhësia (Typ.) : $\geq 350 \text{ cd/m}^2$ Raporti i kontrastit (Typ.) : $\geq 1000:1$ Paraqitja e ngjyrave : $\geq 1073.7\text{M}$ (10 bit) Koha e reagimit : $\leq 5\text{ms}$(GTG) Norma e rifreskimit (Max) : $\geq 144\text{Hz}$
Audio	Altoparlant : $P_o \geq (2\text{W} \times 2)$
I/O Portat	USB-C x 1 (DP Alt Mode) Porta e ekranit 1.4 x 1 HDMI(v2.0) x 2 USB Hub : 4x USB 3.2 Gen 1 Type-A Portë për kufje : Po USB-C Shpërndarja e fuqisë : $\geq 90\text{W}$
Tensioni/rryma	100-240V, 50/60Hz
Mechanical Design	Tilt : Yes (+35° ~ -5°) Swivel : Yes (+45° ~ -45°) Pivot : Yes (+90° ~ -90°) Height Adjustment : 0~150mm

VESA Wall Mounting : 100x100mm
Kensington Lock : Yes

9. PAJISJE PËR HELPDESK

OSHEE sh.a. kërkon të blejë aksesore për nevojat e sektorit të Helpdesk pranë Departamentit të IT me karakteristikat e mëposhtme:

Përshkrimi	Sasia	Njësia
RAM DDR4 (8GB, min. 1600 Mhz)	100	copë
RAM DDR5 (8GB, min. 4800 Mhz)	50	copë
Kabell Display V1.5	20	copë
Kabell HDMI V1.5	20	copë
Switch Gigabit i Pa Menaxhueshëm 5 Porta	10	copë
Set veglash profesionale per njesine e suportit (help-desk)	2	copë
Smartphone / min 8GB RAM / Geekbench: min 3200 pikë / Ekrani min 6.5"/ madhesia e baterise 5000 mAh/ memorje min 128 GB	1	copë
Kufje me mikrofoni	20	copë
Adapter, USB-C to multifunctional port	10	copë
SSD 480 GB SATA III	50	copë
SSD 256 GB, M.2	50	copë
Tastiera me USB, (1,5m gjatësia e kabllit)	50	copë
Mouse me USB 3 butona, (1,5m gjatësia e kabllit)	50	copë
USB 3.0 flash drive 32 GB	50	copë

10. FV. NDËRTIMI I RRJETIT LAN NË 60 DEGË.

OSHEE Group sh.a. kërkon të ndërtohet rrjeti i brendshëm LAN për 60 degë të saj të pozicionura në Tiranë dhe rrethe. Rrjeti duhet ndërtuar i tillë që secili kabull të jetë end to end. Pra, secili kabull duhet të vijojë nga switch-i deri tek pajisja (PC apo printer) pa u ndërprerë me switch-e të tjerë. Të gjithë kabujt duhet të qepen në patch pannel në rack për secilën degë. Pajisjet që nevojiten për të realizuar të gjithë rrjetin janë si vijon:

LISTA E PAJISJEVE PËR DEGËT (VLERËSIMI):

Prizë mbrojtëse nga Tensioni i lartë	60 copë
PDU per rack ≥ 6 poste shuko	60 copë
Patch Pannel cat5e 24 porta	60 copë
Patch kabull 1mt	500 copë
Panel menaxhim kabujsh	60 copë

LISTA E DEGËVE:

Emri i zyrës	Rajoni
KNK Përmet	Gjirokastrë
KNK Sarandë	Gjirokastrë
KNK Tepelenë	Gjirokastrë
Njësia Gjirokastrë	Gjirokastrë
Njësia Përmet	Gjirokastrë
KNK Himarë	Vlorë
KNK Kastrati	Vlorë
KNK Krumë	Kukës
KNK Tropjë	Kukës
Njësia Tropojë	Kukës
KNK 1 Berat	Berat
KNK 2 Berat	Berat
KNK Poliçan	Berat
KNK Ura Vajgurore	Berat
KNK Golem	Durrës
KNK 2 Lushnje	Berat
GO Manëz	Durrës
Njësia Cërrik	Elbasan
KNK Cërrik	Elbasan
KNK 4 Shkodër	Shkodër
KNK Pukë	Shkodër
Njësia Bushat	Shkodër
Njësi Malësia e Madhe	Shkodër
Njësia Vau I Dejës	Shkodër
Njësia Ersekë	Korçë
KNK Maliq	Korçë
Njësia Kurbin	Burrë
Njësia Mirditë	Burrë

KNK Rubik	Burrel
KNK Rrëshen	Burrel
KNK Burrel	Burrel
KNK Klos	Burrel
KNK Dibër	Burrel
KNK Bulqizë	Burrel
Njësia Roskovec	Fier
Njësia Patos	Fier
Njësia Ballsh	Fier
KNK 2 Fier	Fier
KNK Ballsh	Fier
KNK Patos	Fier
GO Sauk	Tiranë
GO Qesarakë	Tiranë
Teknika 2 Ali Demi	Tiranë
GO Qendër 1	Tiranë
KNK Rrogozhinë	Durrës
GO Paskuqan	Tiranë
GO Magazinat e Tregtisë	Tiranë
GO Liqeni I Thatë	Tiranë
Njësia Belsh	Elbasan
GO Kamëz	Tiranë
GO Don Bosco	Tiranë
KNK Manëz	Durrës
DKRH F. Aviacionit	Tiranë
KNK F. Aviacionit	Tiranë
KNK Kombinat 2	Tiranë
KNK Paskuqan	Tiranë
KNK Sauk	Tiranë
GO Vaqar-Ndroq	Tiranë
Arkiva Vaqarr/Magazina	Tiranë
Trans. Zogu i ZI	Tiranë

11. SHERBIME INSTALIMI DHE IMPLEMENTIMI ON-SITE.

Operatori Ekonomik duhet të kryejë instalimin dhe konfigurimet e produkteve që janë ofruar në këtë prokurim, duke mos shkaktuar down-time (ndërprerje të shërbimeve) në sistemet kryesore të Autoritetit Kontraktor.

SHËRBIMET QË DUHET TË KRYHEN

SD-WAN Main hub

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Regjistrimi ne platformen e menaxhimit.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave te klientit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

SD-WAN Spoke

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Regjistrimi ne platformen e menaxhimit.
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave te klientit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

Platforma e menaxhimit.

- Përgatitje e skenarit për implementimin.
- Verifikimi dhe instalimi.
- Regjistrimi i platformes se menaxhimit.

-
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
 - Aktivizimi i licencave.
 - Testimi dhe aksesimi i tyre.
 - Dokumentim i implementimit

Switch me 24 porta.

- Përgatitje e skenarit për implementim.
- Verifikimi dhe instalimi fizik.
- Implementim dhe konfigurim, sipas kërkesave të klientit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

Upgrade të licencave në sistemet ekzistuese Cisco Umbrella dhe ManageEngine.

- Verifikimi dhe instalimi s platformat ekzistuese
- Implementimi dhe konfigurimi, sipas kërkesave të klientit.
- Integrimi në network të institucionit.
- Aktivizimi i licencave.
- Testimi dhe aksesimi i tyre.
- Dokumentim i implementimit

Shërbime Instalimi dhe konfigurimi të software, hardware si dhe verifikimi i garancive për periudhën një vjeçare për të gjitha produktet në këtë prokurim.

- Përgatitja e skenarit e detajuar për ndërtimin, instalimin, konfigurimin e shërbimeve.
- Përgatitja e skemave të implementimit.
- Testimi i shërbimeve të implementuara.
- Dokumentim i çdo instalimi, konfigurimi sistemesh: software, hardware.
- Dokumentim i suportit, mirëmbajtjes së sistemeve të implementuara.

12. SHËRBIME MIRMBAJTJE /SUPORTI REMOTE DHE ON-SITE.

Objekti i shërbim mirëmbajtje:

OSHEE sh.a, më anë e këtij prokurimi, ka për qëllim të sigurojë funksionalitetin e këtyre pajisjeve dhe riparimin e tyre, sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware dhe software të mos afektojnë punën.

Shërbim mirëmbajtje:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbim mirëmbajtje për pajisjet ekzistuese aktualisht në gjendje pune dhe pajisjet e reja në këtë prokurim.

Termat për shërbim mirëmbajtje:

- Operatori ekonomik duhet të ketë skuadër të dedikuar për suportin, mundësi të qëndrimit të thirrjeve dhe të një kontakti të vetëm që do koordinojë dhe menaxhojë thirrjet e OSHEE Group sh.a.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë kohë të shpejtë të pranimit të thirrjes, maksimumi 1 orë nga log-ini i thirrjes së OSHEE Group sh.a.
- Tekniku duhet të paraqitet në vendndodhjen e OSHEE Group sh.a. brenda 4 (katër) orëve nga log-ini i thirrjes dhe raportimit të problemit, në rast se thirrja konsiderohet urgjente dhe brenda ditës së nesërme të punës për thirrje jo urgjente. Tekniku gjatë kohës së paracaktuar duhet të fillojë diagnostikimet on-site dhe mbështetje për zgjidhjen e problemeve.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë gatishmërinë e suportit 24/7.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë mirëmbajtje të plotë të hardware-t me zëvendësim falas të pajisjes ose pjesëve të këmbimit në rast defekti.
- Në rast të ndërrimit të pajisjeve, duhet të ndërrojnë pajisjet e dëmtuara dhe të kryejë konfigurimet bazë të nevojshme pas ndërrimit.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë se do të kryejë diagnostikime proaktive me mbështetje të vendorit dhe hapje case TAC, Update të software-ve të Sistemit të Operimit (OS), duke përfshirë minor, major releases.
- Operatori ekonomik duhet të kryejë update të Software-ve.
- Operatori ekonomik duhet të kryejë ndryshime në konfigurime dhe rikonfigurime sipas kërkesave të OSHEE sh.a, në varësi të ndryshimit të dizajnit të Network-ut.

Nivelet e shërbimit të mirëmbajtjes dhe proceset:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë:

1. Suport proaktiv.

Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, shërbime dhe suport proaktiv, të cilët duhet të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave dhe duhet të mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e suportit proaktiv, duhet të kryhen pranë ambienteve të OSHEE

GROUP sh. a, përveç rasteve kur OSHEE GROUP sh.a. përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

2. Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e OSHEE GROUP sh.a).

Operatori ekonomik duhet të jetë në dispozicion gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Dielë, 24/7, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "*Alarmeve Madhore*" të raportuara nga personeli i autorizuar i OSHEE GROUP ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin *Alarm Madhor* do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për shërbime riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të sistemeve të mbuluara që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëhershme e të konsiderueshme të sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i OSHEE

GROUP sh.a, të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin "*Alarmeve Madhore*", duhet të adresohen nën Shërbime të Suportit proaktiv.

3. Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

OSHEE Group sh.a. do të njoftojë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion dhe do të presë të kontaktohet nga ne me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori ekonomik duhet të kontaktojë OSHEE Group sh.a. dhe të konfirmojë marrjen e *Alarmit Madhor*, brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. Në momentin e njohjes së thirrjes, OSHEE Group sh.a. do të vendosë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting, dhe do të asistojë OE gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. OSHEE Group do të bashkepunojë me kërkesën e OE për të ndihmuar, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

4. Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.

Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting shkakun e Alarmit madhor, atëherë duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë OSHEE Group sh.a, brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti marrjes së njoftimit për *Alarm Madhor*. Me të mbërritur, tekniku do të mbështetet me asistencë nga OSHEE Group sh.a. dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

5. Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit.

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa:

- (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë",
- (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër,
- (c) Të përcaktojë, se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose

(d) Të arrijë në konkluzion që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Teknikët e shërbimit të operatorit ekonomik duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë të drejtpërdrejtë me prodhuesin. Në rast se do të jetë i nevojshëm zëvendësimi i pjesëve të këmbimit, atëherë OE duhet të kryejë të gjitha procedurat respektive me prodhuesin për lokalizimin e pjesës, heqjen, eksportin, transportin, importin, vendosjen dhe rikonfigurimet përkatëse. Kostot e pjesëve të dëmtuara dhe kostot e shërbimit do të merren përsipër nga operatori ekonomik për të gjithë periudhën e kontratës.

6. Shërbimet e tjera:

Operatori ekonomik duhet të krijojë/diskutojë me OSHEE GROUP sh.a. një agjendë periodike kontrollesh si më poshtë:

Javore

- (i) Kontrole të log-eve të pajisjeve të rrjetit;
- (ii) Mirëmbajtje proaktive.

Mujore

- (iii) Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës HW të OSHEE GROUP sh. a;
- (iv) Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardware, analizë e tyre.
- (v) Rekomandime për upgrade të mundshme hardware

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Implementimi dhe Investimi në një zgjidhje të konsoliduar për një komunikim të sigurt në distancë”.

Afatet e ekzekutimit: Implementimi 6 (gjashtë) muaj nga nënshkrimi i kontratës, pajtimi 1 vit nga implementimi

1	2	3	4
---	---	---	---

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Koha e pajtimit (vit)
1	F.V SD-WAN NEXT GENERATION FIREWALL MAIN HUB	2/copë	1
2	F.V SD-WAN NEXT GENERATION FIREWALL SPOKE TIP.2	60/copë	1
3	F.V PLATFORMA E MENAXHIMIT	1/set	1
4	F.V SWITCH ME 24 PORTA	60/copë	1
5	F.V UPGRADE ME LICENCA TE SISTEMIT EKZISTUES CISCO UMBRELLA SECURE INTERNET GATEWAY	500/copë	1
6	F.V UPGRADE ME LICENCA TE SISTEMIT EKZISTUES PËR MENAXHIMIN E PAJISJEVE DHE MONITORIMIN NE KOHE REALE	1/set	1
7	LAPTOP TË AVANCUAR	4 copë	1
8	MONITORË ADVANCED 27"	14 copë	1
9	PAJISJE PËR NEVOJAT E HELPDESK	1/set	1
10	NDËRTIM RRJETI KOMPJUTERIK NË 60 DEGË	1/set	1
11	SHERBIME INSTALIMI DHE IMPLEMENTIMI ON-SITE	1/set	1
12	SHERBIME MIRMBAJTJE /SUPORTI REMOTE DHE ONSITE	1/Vit	1

PLANI I IMPLEMENTIMIT

Afati i realizimit për implementimin do të jetë 6 muaj pas lidhjes së kontratës, përshkruar në sipas tabelës. Pajtimi 1 vit nga implementimi.

1	2	M1	M2	M3	M4	M5	M6
